



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **HARTA RRUGORE E ASK-së PËR VITIN 2014**

**Dhjetor, 2013**  
**Prishtinë**

## PARATHËNJE

Ky dokument përmban planin operacional të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe është i bazuar në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare për 2014 të ASK-së, si dhe në Programin 5 vjeçar të Statistikave i cili është aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe është vendosur në Gazetën Zyrtare.

Në vitin 2014 ASK do të jetë e përqendruar në zbatimin e Programit Vjetor të Statistikave Zyrtare 2014, pastaj në zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017, me vazhdimin e zbatimit të Rregullores për Riorganizimin e ASK-së, ngritjes së kapaciteteve në ASK, posaçërisht në statistikat ekonomike dhe në Departamentin e politikave, planifikimit, koordinimit dhe komunikimit.

Ashtu siç tregon edhe titulli, ky dokument paraqet aktivitetet më të rëndësishme të ASK-së dhe është i bazuar në planet dhe detyrat e rregullta të paraqitura në formë të agreguar (përgjithësuar), përderisa planet më të detajizuara ekzistojnë në dokumentet e brendshme të departamenteve përkatëse të ASK-së.

Për vitin 2014, ASK-ja do të përgatisë një Raport Vjetor i cili mbështetet në krahasimin e arritjeve në ASK dhe Sistemin Statistikor të Kosovës, bazuar në planifikimet e bëra për këtë periudhë, në mënyrë që sipas kërkesave të Ligjit të Statistikave Zyrtare të Kosovës Raporti të dërgohet në Qeveri dhe Kuvendin e Kosovës për miratim.

## PËRMBAJTJE

1. ORGANIZIMI i ASK-së.....	4
1.1. Aktivitete te rëndësishme që priten të finalizohen në 2014.....	4
2. KËSHILLI STATISTIKOR.....	5
3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2014.....	5
3.1. Departamenti i Administratës.....	6
3.2. Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim .....	6
3.3. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve.....	6
3.4. Departamenti i Statistikave Ekonomike .....	7
3.5. Departamenti i Statistikave Sociale .....	12
3.6. Departamaneti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.....	14
3.7. Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative.....	16
4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORËT .....	17
5. SFIDAT .....	17
6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE & QASJA.....	17
7. BUXHETI .....	21
Aneksi 1 Organogrami i ASK nga muaj Janar 2014 .....	22

## 1. ORGANIZIMI I ASK-së

ASK ka gjatë viti 2013 ka zbatuar Rregulloren për Riorganizimin e ASK-së, Rregullore e cila është aprovuar Qeveria e Kosovës dhe me finalizimin e zbatimit të sajë, pritet të ndryshojë në mënyrë substanciale rregullimi ekzistues i ASK-së. Struktura e re është bashkëngjitur në këtë dokument si Aneks.

Me aprovimin e Ligjit mbi statistikat zyrtare dhe Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017, para ASK-së shtrohen detyra dhe përgjegjësi të mëdha në ngritjen edhe zhvillimin e statistikave zyrtare në nivel vendi në harmoni me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare statistikore.

Prandaj si rezultat i Ligjit të lartcekur, ASK-ja ka përgjegjësi të përgjithshme në prodhimin e statistikave zyrtare dhe për çështje të tjera që parashihen me ligj dhe me aktet nënligjore.

Si rrjedhojë e kësaj gjatë vitit 2014, ASK-ja planifikon:

- Përcaktimin dhe zhvillimin e metodologjisë statistikore, klasifikimin dhe përdorimin e standardeve për prodhimin e statistikave zyrtare. Për të gjitha publikimet e dala nga ASK-ja do të zbatohen të gjitha metodologjitë dhe standardet e statistikave evropiane.
- Ti paraqesë, përmes Kryeministrit, për miratim Qeverisë dhe Kuvendit Raportin Vjetor 2013 mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Raporti vjetor i miratuar publikohet.
- Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare kompetente për statistikat zyrtare, për të mundësuar krahasimin e statistikave zyrtare me statistikat e prodhuara në sisteme të tjera statistikore. Bashkëpunimi statistikor me organizatat ndërkombëtare me pjesëmarrjen e stafit të ASK-së në takime, punëtori dhe seminare në fusha të ndryshme statistikore, si dhe me ekspertët ndërkombëtar në ASK.
- Te realizoj Projektin kapital të Regjistrimit të Bujqësisë

### 1.1 Aktivitete të rëndësishme që priten të finalizohen në 2014

- Rritjen e kapaciteteve në ASK (njerëzore dhe infrastrukurore) dhe fuqizimi i statistikave ekonomike.
- Prodhimi i statistikave sipas standardeve evropiane dhe botërore dhe zgjerimi i volumit të tyre, pjesëmarrja në takime ndërkombëtare, implementimi i metodologjisë statistikore evropiane.
- Fillimin e zbatimit të kornizës së vlerësimit të performancës të PVSZ.
- Realizimi i projektit të Regjistrimit të Bujqësisë-projekt që do të realizohet në kuadër të IPA 2012 dhe IPA 2013 me pjesëmarrje të donatorëve të tjerë dhe participim të Qeverisë së Kosovës;

- Sigurimi i buxhetit të nevojshëm nga buxheti i Kosovës dhe nga donatorët për vitin 2013 – ASK ka kodin e vet buxhetor ku sipas plan programit bëhet edhe aprovimi i buxhetit për ASK, ndërsa nga donatorët bëhet mbështetja përmes projekteve të ndryshme.
- Plotësim-Ndryshimi i Ligjit të Statistikave Zyrtare dhe Ligji për ndarjen Rajonale statistikore sipas NUTS

## 2. KËSHILLI STATISTIKOR

Këshilli përbëhet nga dymbëdhjetë (12) anëtarë dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, që përfaqësojnë ministrinë kyçe, bankën qendrore, administratën tatimore, universitetet, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile siç janë cekuar më poshtë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- Ministria e Financave
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
- Universiteti i Prishtinës
- Administrata Tatimore
- Zyra e Planifikimit Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit
- Aleanca e Kosovare e Bizneseve
- Instituti për Menaxhimin e Ndërmarrjeve dhe Inxhinieri (IMNI)

Këshilli Statistikor ashtu siç ka vepruar deri tash, do të jep rekomandime mbi përgatitjen dhe realizimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2013 si dhe mbi zhvillimin dhe funksionimin e gjithëmbarshtëm të ASK-së, respektivisht Sistemit Statistikor të Kosovës.

Këshilli është themeluar me Vendim të Kryeministrit dhe do të funksionojë në mbështetje të rregullores së miratuar konform ligjit të statistikave zyrtare. Këshilli Statistikor ka dërguar Raportin e parë në ZKM dhe po ashtu gjatë vitit tjetër do përgatis Raport Vjetor 2013 dhe do ta dërgoj në ZKM.

## 3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2014

Në ASK parashihet të ngritën kapacitetet sipas standardeve dhe metodologjive të kërkuara nga Eurostati. Ky zhvillim i departamenteve do të bëhet në pajtim me politikat e diseminimit për evitimin e të gjitha gabimeve të mundshme në publikimet e ASK-së; zhvillimin mëtejshëm të metodologjive dhe teknologjisë statistikore; zhvillimin e politikave të standardizimit dhe mbështetjen me ekspertë ndërkombëtarë për implementimin e këtyre standardeve.

ASK në kuadër të këtij zhvillimi do ofroj ndihmë profesionale për interpretimin e saktë të të dhënave zyrtare statistikore.

Më poshtë janë dhënë zhvillimet e parapara sipas departamenteve për vitin 2014.

### 3.1. Departamenti i Administratës

Departamenti i Administratës është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative në ASK si: shërbime financiare, kontrollin buxhetor dhe mbështetje për menaxhimin e buxhetit; shërbime të personelit duke mbuluar mirëqenien, rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore; prokurimin dhe shërbimet për menaxhimin e kontratave (menaxhimi i aseteve, pronës dhe shërbimet e logjistikës). Në kuadër të Departamentit të Administratës, sipas Rregullores për Riorganizim janë angazhuar një drejtor dhe 13 zyrtarë.

Një prej pikave kyçe të fokusit të këtij departamenti do të jetë riorganizimi, rekrutimi dhe plotësimi i pozitave ekzistuese të lira në ASK në mënyrë që të arrihet kompletimi i personelit të ASK-së brenda limiteve të lejuara. Gjithashtu prioritet do të jetë edhe mbështetja e departamenteve prodhuese lidhur me finalizimin e prodhimeve statistikore.

### **3.2. Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim**

Sipas Rregullores për Riorganizim të ASK-së është krijuar departamenti të ri në ASK: Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim. Në këtë departament janë plotësuar tashmë disa pozita kyçe dhe gjatë vitit 2014 do të plotësohet edhe pozita e Drejtorit, pozitë e cila do të shërbejë edhe si zëvendës Kryeshef Ekzekutiv (KE) të ASK-së. Ky Departament është përgjegjës për planifikimin në ASK, për përmirësimin e bashkëpunimit (me institucionet vendore dhe ndërkombëtare), koordinimin (brenda ASK-së dhe Sistemit Statistikor të Kosovës), zhvillimin dhe zbatimin e politikave si dhe monitorimin e prodhimit të statistikave zyrtare. Po ashtu ky departament do të ketë rol qendror në monitorimin dhe implementimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017.

Departamenti PPKK-së do të ofrojë këshilla ligjore për ASK-në dhe Sistemin më të gjerë Statistikor të Kosovës dhe për palët të tjera të interesuara sipas nevojës.

Ky departament duhet të paraqesë të dhëna te Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së lidhur me performancën e departamenteve prodhuese dhe mbështetëse në ASK

### **3.3. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve**

Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve, si departament i ri në ASK, do të jetë përgjegjës për dizajnimin, zbatimin dhe organizimin e regjistrimeve dhe anketave sociale, ekonomike dhe bujqësore në ASK. Ky departament ka: divizionin e regjistrimit dhe divizionin e anketimeve. Departamenti i ri do të ketë nën ombrellën e vet edhe zyrtarë rajonale të ASK-së. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve do të ketë rolin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve operative të zyrtarëve rajonale të ASK-së lidhur me mbledhjen e të dhënave në terren.

Në kuadër të përgatitjeve për regjistrimin e Bujqësisë, departamenti do të mbështesë të gjitha aktivitetet dhe kërkesat që dalin nga ekipet e Projektit të Regjistrimit të Bujqësisë.

Do të bëjë harmonizimin e metodave për grumbullimin e të dhënave për anketa si dhe do të bëjë monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e punëve në kuadër të anketave të nevojshme për hulumtimet e ndryshme statistikore.

Divizioni i regjistrimeve do të ofrojë bashkëpunim me departament tjera në ASK dhe jashtë ASK-së. Po ashtu, departamenti do të përgatitë raportet mbi ecurinë e aktiviteteve të parapara.

### **3.4. Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare**

Departamenti në baze të strukturës organizative aktualisht përbëhet nga tri divizione: divizioni i llogarive kombëtare, i statistikave të çmimeve dhe divizioni i ndërmarrjeve dhe statistikave të tregtisë së jashtme.

Në programin e vitit 2014 departamenti ka këto prioritete: Kalimi në klasifikimin e NACE 2, Përpilimi i Llogarive kombëtare me metodologjinë e re (ESA 2010 dhe SNA 2008), Përmirësimi i cilësisë së regjistrit të bizneseve, fillimi i publikimeve të reja tremujore si BPV në dy qasjet, Indeksi i Kostos së Ndërtimit, Statistikat afatshkurta të Industrisë dhe Statistikat afatshkurta të Ndërtimit. Shkurtimi i afateve të publikimeve mujore (tregtisë së jashtme nga prilli t+ për më pak se 30 ditë), vjetore (BPV qasjen e Prodhimit t+11 muaj) dhe shumica e statistikave tremujore.

Fillimi i projektit MB - IPA 2012 me projektet të veçanta të kësaj fushe. Fillimi i projektit të binjakëzimit për mbështetje të statistikave të biznesit, Llogarive Kombëtare dhe vazhdimi i asistencës teknike nga SIDA për statistikave të çmimeve do të jone mundësi e mirë për arritjen e objektivave tona.

Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave Ekonomike në vitin 2014.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Statistikat e tregtisë së Jashtme	Nën 2013	Dhjet 2013	Jan 2014	Shk 2014 & Mar 2014	Prill 2014	Maj 2014 & 2013	Qer 2014	Kor 2014	Gush 2014	Shta 2014	Tet 2014	Nën 2014
Indeksi i Çmimeve të Konsumit	Dhjet 2013	Jan 2014	Shk 2014	Mar 2014	Prill 2014	Maj 2014 & 2013	Qer 2014	Kor 2014	Gush 2014	Shta 2014	Tet 2014	Nën 2014
Statistikat e Hotelarisë			TM4 /2013			TM1 /2014			TM2 /2014			TM3 /2014
Indeksi i çnimit të Importit			TM4 /2013			TM1 /2014			TM2 /2014			TM3 /2014
Bilanci i Energjisë në Kosovë			TM4 /2013			TM1 /2014			TM2 /2014			TM3 /2014
Indeksi i çmimeve të Prodhimit			TM4 /2013			TM1 /2014			TM2 /2014			TM3 /2014
Rep.stat mbi ndërmarrjet në Kosovë		TM4 /2013			TM1 /2014			TM2 /2014			TM3 /2014	
Statistikat e Transportit		TM4 /2013			TM1 /2014			TM2 /2014			TM3 /2014	
Llogarit Qeveritare						2013						
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e shpenzimeve									2013			
Rezultatet e Anketes Strukture te Ndërmarrjeve												2013
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e Prodhimit											2013	
BVP*tremujore-Qasja e shpenzimeve dhe prodhimit												TM1 /2014
Indeksi i Kostos së Ndërtimit			TM4 /2013			TM1 /2014			TM2 /2014			TM3 /2014
Statistikat tremujore për Industri			TM4 /2013			TM1 /2014			TM2 /2014			TM3 /2014
Statistikat tremujore për Ndërtim			TM4 /2013			TM1 /2014			TM2 /2014			TM3 /2014

Vëreni se muaji i shkruar ne kutinë e hijëzuar paraqet muajin/vitin e raportuar përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

/\* Katër publikimet e fundit janë publikime të reja të cilat publikohen për herë të parë.



Gjatë vitit 2014 planifikohen të realizohen këto aktivitete sa i përket statistikave makroekonomike:

**Aktivitetet tjera**

- a) Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2013
  - Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra) Prill-Qershor 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave Maj -Shtator 2014
  - Përgatitja e të dhënave përfundimtare për BPV Tetor 2014
  - Publikimi i të dhënave Dhjetor 2014
  -
- b) Anketa për azhurnimin e Regjistrit Statistikor të Bizneseve 2014
  - Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra) Shtator-Tetor 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave Tetor -Dhjetor 2014
- c) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për Industri TM4 /2013,
  - Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Janar - Shkurt 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave Janar -Mars 2014
  - Publikimi i të dhënave Mars 2014
- d) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për Industri TM1 /2014,
  - Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Prill-Maj 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Prill - Qershor 2014
  - Publikimi i të dhënave Qershor 2014
- e) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për Industri TM2 /2014
  - Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Korrik - Gusht 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Korrik – Shtator 2014
  - Publikimi i të dhënave Shtator 2014
- f) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për Industri TM3/2014
  - Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Tetor –Nëntor 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Tetor - Dhjetor 2014
  - Publikimi i të dhënave Dhjetor 2014
- g) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për Ndërtim TM4 /2013,
  - Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Janar - Shkurt 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave Janar -Mars 2014
  - Publikimi i të dhënave Mars 2014
- h) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për Ndërtim TM1 /2014,
  - Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Prill-Maj 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Prill - Qershor 2014
  - Publikimi i të dhënave Qershor 2014
- i) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për Ndërtim TM2 /2014
  - Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Korrik - Gusht 2014

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Korrik – Shtator 2014
  - Publikimi i të dhënave Shtator 2014
- j) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për Ndërtim TM3/2014
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Tetor –Nëntor 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Tetor - Dhjetor 2014
  - Publikimi i të dhënave Dhjetor 2014
- k) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për tregti me pakice TM4 /2013,
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Janar - Mars 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave Shkurt -Mars 2014
- l) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për tregti me pakice TM1 /2014,
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Prill -Maj 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Maj - Qershor 2014
- m) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për tregti me pakice TM2 /2014
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Korrik - Gusht 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Gusht – Shtator 2014
- n) Anketa Tremujore e ndërmarrjeve për tregti me pakice TM3/2014
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Tetor –Nëntor 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Nëntor -Dhjetor 2014
- o) Anketa për Çmimet e kostos së ndërtimit TM4 /2013,
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Janar - Shkurt 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave Janar -Mars 2014
  - Publikimi i të dhënave Mars 2014
- p) Anketa për Çmimet e kostos së ndërtimit TM1 /2013,
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Prill-Maj 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Prill - Qershor 2014
  - Publikimi i të dhënave Qershor 2014
- q) Anketa për Çmimet e kostos së ndërtimit TM2 /2013
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Korrik - Gusht 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Korrik – Shtator 2014
  - Publikimi i të dhënave Shtator 2014
- r) Anketa për Çmimet e kostos së ndërtimit TM3/2013
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), Tetor –Nëntor 2014
  - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe analiza e të dhënave, Tetor - Dhjetor 2014
  - Publikimi i të dhënave Dhjetor 2014
- s) Kalimi në klasifikimin e NACE 2, Implementimi i aktiviteteve të parapara:

- Krijimi i databazës (Mars 2014)
  - Lidhja me tabelat Korrespunduese (Maj-Qershor 2014)
  - Këmbimi i te dhënave me ARBK ATK (Qershor – Korrik 2014)
  - Raporti i përgjithshëm (Gusht 2014)
  - Aplikimi dhe hyrja ne Fuqi (Shtator 2014)
- t) Projekte te IPA 2012 (MB)\* -Programi i bashkëpunimit statistikor me shumë përfitues IPA 2012
- Pariteti i Fuqisë Blerëse
  - Llogarive Kombëtare
  - Statistikat afatshkurtra te ndërmarrjeve
  - Statistikat e tregtisë së jashtme për mallra dhe
  - Indeksi i harmonizuar i Çmimeve te Konsumit

/\* Dinamika e realizimit te projekteve të IPA 2012 do te jetë sipas kontratës së nënshkruar. Ky projekt fillon në vitin 2014 dhe deri ne vitin 2016.

### 3.5. Departamenti i Statistikave Sociale

Departamenti i Statistikave Sociale (DSS), përbëhet nga dy divizione, nga divizioni i statistikave sociale dhe divizioni i statistikave të popullsisë. Stafi i Departamentit të statistikave sociale përbëhet nga: 1 drejtor, 2 shefa të divizioneve dhe 19 zyrtarë.

Lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave Sociale në vitin 2013

Muaji i botimit	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare					2013						
Anketa e Fuqisë Punëtore				2013							
Statistikat e Jurispodencës, për personat e madhor								2013			
Statistikat e Arsimit										2013/2014	
Statistikat e Arsimit për parashkollor (3-6 vjeç)						2013/2014					
Statistikat e Arsimit për arsimin fillor (6 -11 vjeç)					2013 /2014						
Statistikat për ars. e ulët dhe të mes. të lartë (15 -19 vjeç)							2013 /2014				
Statistikat e Arsimit Universitar								2012 /2013			
Statistikat e Varfërisë								2012			
Statistikat e Jurispodencës për persona të mitur									2013		
Statistikat e Kulturës									2013		
Statistikat e Mirëqenies sociale	2013			TM1 /2014			TM2 /2014		TM3 /2014		
Statistikat e Shëndetësisë										2013	
Statistikat e sportit										2013	
Lindjet në Kosovë					2013						
Vdekjet në Kosovë						2012					
Kurorëzimet dhe shkuroëzimet në Kosovë						2012					
Gratë dhe Burrat në Kosovë		2011-2012									
Shkaqet e Vdekjeve në Kosovë											2013

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar të botimit përdërisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen

**Aktivitetet tjera**

- a) Publikimi i botimit “Statistikat e varfërisë 2012”, Shtator 2014. Ky aktivitet është rezultat i bashkëpunimit me Bankën Botërore.
- b) Zhvillimi i Anketës së Grupimeve të Indikatorëve të Shumëfishtë (MICS5) në bashkëpunim me UNICEF-in.
- c) Vazhdimi i punës lidhur me iniciativën rajonale të mbledhjes së të dhënave për indikatorët kryesor rreth fëmijëve dhe femrave (TransMonEE)-në bashkëpunim me UNICEF.
- d) Digjitalizimi i Regjistrimit Demografik-vazhdon bashkëpunimin me Agjencinë e Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) si udhëheqës të projektit për digjitalizimin e regjistrit të gjendjes civile.
- e) Digjitalizimi i të dhënave të statistikave të arsimit në kuadër të MASHT-it.

### 3.6. Departmaneti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Departamenti do të jetë përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e statistikave zyrtare të besueshme dhe me kohë për bujqësi, pylltari, statistika agro-monetare dhe të mjedisit si dhe standardizimi i prodhimit të këtyre statistikave me BE-n.

Bazuar në strukturën e re të organizimit të ASK-së, departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit ka dy divizione në kuadër të saj: divizioni i statistikave të bujqësisë dhe ai i statistikave të mjedisit. Si edhe në vitin e shkuar, departamenti i bujqësisë dhe mjedisit do të vazhdojnë nxjerrjen e botimeve të rregullta të parapara në kalendarin e botimeve 2014. Prioritet e departamentit për vitin 2014 do të jenë dhe regjistrimi i bujqësisë, harmonizimi me standarde dhe me metodologjitë e Eurostatit, përmasimi i kualitetit të këtyre statistikave dhe shkurtimi i kohës së prodhimit të statistikave.

Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në vitin 2014

Muaji i botimit	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Indeksi i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në Bujqësi	2005-2013 TM4/ 2013			TM1/ 2014			TM2/ 2014			TM3/ 2014	
Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në Bujqësi	2005-2013 TM4/ 2013			TM1/ 2014			TM1/ 2014			TM3/ 2014	
Anketa e mbeturinave industriale											2013
Anketa e mbeturinave komunale											2013
Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore				2013							

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Me aprovimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë (Ligji Nr. 04/L – 127) nga Parlamenti i Kosovës në dhjetor të vitit 2012, Regjistrimi i bujqësisë ishte planifikuar të kryhet në nëntor të vitit 2013. Por me mbajtjen e zgjedhjeve lokale në nëntor të vitit 2013 (kjo periudhë e njëjtë me periudhën e regjistrimit të bujqësisë) regjistrimi i bujqësisë është shtyrë për vitin 2014. Departamenti i bujqësisë dhe mjedisit si prioritet në vitin 2014 ka realizimin e regjistrimit të bujqësisë. Ky regjistrim kryhet nga ASK në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).

Procesi i regjistrimit të bujqësisë në vitin 2013:

- Siç është e paraparë me Ligjin për RB-së dhe Planin e Veprimit të Projektit, është themeluar Komisioni i RB-së dhe ai është i përbërë nga 16 anëtarë.
- Në 34 Komuna janë krijuar Komisionet Komunale të Regjistrimit (KKR-të). KKR-të përbëhen prej 5 anëtarëve. Në çdo KKR janë përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Agjencisë së Statistikave të Kosovës

(ASK) dhe të Komunës. Këto komisione do të riformohen në komunat ku pas zgjedhjeve ka pasur ndryshime.

- Është përgatitur raporti final mbi regjistrimin pilot të bujqësisë.
- Manuali dhe Pyetësi i RB-së është rishikuar, ndryshuar dhe është përshtatur për kryerjen e RB në qershor 2014.
- Komunikimi dhe Informimi ka hartuar strategjinë, planin e aktiviteteve me te detajuar për RB.
- Logjistika si një pjesë shumë e rëndësishme e këtij procesi kompleks operacional ka bërë finalizimin e një sërë dokumentesh relevant siç janë: Plani logjistik, Manuali dhe plani i rekrutimit, Manuali për Komisionet Komunale të Regjistrimit( KKR-të) dhe dokumente tjera. Te gjitha këto dokumente janë si draft i avancuar dhe janë ne proces te finalizimit.
- Hartografia ka përgatitur Hartat për QR dhe janë të gatshme përdorim për regjistrimin e bujqësisë. Kjo përfshin hartat për çdo Qark Regjistruar ( numri i përgjithshëm i QR-ve është 4521.)
- Janë organizuar dhe realizuar vizita studimore dhe punëtori lidhur me RB. Me qëllim të shkëmbimit të përvojave, si dhe në kuadër të bashkëpunimit me një fokus të veçantë në Regjistrimin e Bujqësisë, janë realizuar dy vizita studimore në Institutin e Statistikave (INSTAT) në Tiranë (Shqipëri ) dhe në Institutin e Statistikave të Italisë (ISTAT).Me qëllim të finalizimit të instrumenteve të regjistrimit dhe planeve të logjistikës dhe dokumenteve, janë organizuar dhe realizuar tri punëtori si në vijim.

Aktivitetet e mëtutjeshme në vitin 2014:

1. Realizimi i regjistrimit të bujqësisë

- Rishikimi i planit te aktiviteteve për RB dhe përshtatja e tyre me propozimin e ri për RB qershor 2014
- Rishikimi i buxhetit të RB.
- Finalizimi, lekturmi dhe printimi i instrumenteve statistikore për RB (pyetësor,udhëzues dhe dokumentet tjera).
- Finalizimi i materialit te trajnimeve.
- Përshtatja e aplikacionit për futjen e shënimeve te RB sipas propozimit/sipas ndryshimit te pyetësorit,rregullave te editimit etj.
- Parapërgatitje tjera për fillimin e regjistrimit të bujqësisë
- Realizimi i regjistrimit të bujqësisë (qershor 2014)
- Realizimi i anketës post- regjistruese të bujqësisë.
- Përgatitja e planit te tabelimit për RB.

2. Publikimi i botimit “Llogaritë ekonomike në bujqësi 2013”. Edhe pse ky publikim nuk është paraparë në kalendarin e rregullt të publikimeve, mund të realizohet në rast se do të ekzistojë mbështetja teknike nga SIDA/SCB.

### 3.7 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative

Departamenti i Metodologjisë dhe TI ka dy divizione sipas planit të riorganizimit: divizioni i Metodologjisë dhe diseminimit dhe divizioni i Teknologjisë Informative.

Divizioni i TI-së do të vazhdojë ti mbështes departamentet prodhuese duke përmirësuar sistemin e brendshëm të TI-së (Intranetin), do të vazhdohet me migrimin e të gjitha data bazave në platformën e SQL, do të zhvillohen aplikacione speciale ku për synim do të kenë digjitalizimin e anketave ku prioritet për vitin 2014 do të jenë statistikat vitale dhe statistikat e arsimit. Do të rrisë bashkëpunimin me MAP-in me qëllim që të bëhemi pjesë e projekteve qeveritare përmes e-Qeverisjes, do të bashkëpunojmë me institucione tjera MPB, MSH, MASHT dhe institucione tjera me qëllim të përmirësimit të sistemit për shkëmbimin e të dhënave dhe integrimin e zyrave rajonale në sistemin e TI-së së ASK-së.

Njësia e GIS-it do të integron Orto-fotot 2012 në platformën e vet dmth të GIS-it, do të mbështet statistikat prodhuese me ofrimin e të dhënave hapësinore si dhe në krijimin e hartave tematike me theks të veçantë projektin për regjistrimin e bujqësisë.

Sipas planit të aktiviteteve të TI-së 2013-2017, për vitin 2014 do të jenë edhe disa aktivitete tjera të cilat pritet të realizohen në bashkëpunim me donatorët (IPA 2012 - projekti i binjakëzimit me statistikat daneze, SIDA suedeze dhe UNICEF);

- Krijimi i një databazë unike për ueb shpërndarje (Implementimi i PC-Axis)
- Krijimi i një databazë për arkivimin dhe shpërndarjen e Metadatave
- Shpërndarja dinamike e të dhënave të dala nga anketa e MICS-it
- Dizajnimi i udhëzuesve për tabela, grafikone për publikime të printuara dhe elektronike

Ndërsa si aktivitete shitesë për Divizionin e Metodologjisë për vitin 2014 planifikohen këto aktivitete.

- Vjetari Statistikor i ASK-së, i cili planifikohet të përgatitet gjatë muajve të parë të Vitit 2014.
- Nxjerrja e Mostrave për Anketën e Buxhetit familjar, Anketën e Fuqisë Punëtore si dhe Anketën e Ekonomive familjare Bujqësore.
- Nxjerrja e Mostrave edhe për Hulumtime tjera shitesë të cilat mundë të kërkohen nga Institucionet e ndryshme ndërkombëtare apo edhe ato vendore.
- Llogaritja e Peshave për Hulumtimet dhe Anketat e lartcekura.

Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Metodologjisë dhe TI në vitin 2014

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Kosova në shifra					2013							
Buletini tremujor	Tet-Dhj 2013			Jan-Mar 2014			Prill-Qer 2014			Korr-Sht 2014		
Atlasi statistikor										2011		
Fletë palosja e ASK-së												2014
Kalendari i botimeve të ASK											2015	
Kalendari vjetor i ASK-së												2015
Katalogu i publikimeve të ASK		2013										

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin në të cilin publikimet priten të shpërndahen



#### 4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORËT

Fondet e EU-së dhe SIDA do të vazhdojnë të mbështesin ASK-në si donatorë kryesor. Donatorë tjerë të rëndësishëm janë FMN, Banka Botërore, UNFPA , UNICEF, UNDP etj.

IPA 2011- programi rajonal shumpërfitues do të vazhdoj të mbështes ASK-në në 13 pilot projekte, si dhe do të mbështes stafin e ASK-së për pjesëmarrje në takimet, konferencat, trajnimet, punëtoritë, grupet e punës që do të inkorporohen në instrumentin planifikues të aktiviteteve Mc-listë nga Eurostat për vitin 2013.

IPA 2012 do të mbështesë zhvillimin e statistikave ekonomike. SIDA/SCB-do të mbështesë forcimin e kapaciteteve statistikore në ASK për një periudhë katër vjeçare.

UNICEF do të mbështesë statistikat sociale duke mbështetur realizimin e anketës së MICS5 (anketa e grupeve të indikatorëve të shumëfishtë) dhe rritjen e kapaciteteve, duke shtuar një staf dhe një konsulentë si asistencë.

UNICEF do të mbështesë ASK-në në zhvillimin e Fletushkave mbi politikat në Kosovë dhe rezultatet e regjistrimit të popullsisë lidhur me një mori të temave të ndryshme.

#### 5. SFIDAT

Një ndër sfidat kryesore të ASK-së në vitin 2014 është mungesa e buxhetit dhe mungesa e stafit.

Po ashtu sfidat tjera me të cilat pritet të ballafaqohet ASK janë:

- finalizimi i zbatimit të planit të riorganizimit të ASK-së
- zbatimin e programit të statistikave zyrtare (PSZ)
- përmirësimin e vazhdueshëm të dhënave statistikore
- krijimin e një sistemi unik statistikor të TI-së;
- realizimin e projektit të regjistrimit të bujqësisë
- zbatimin e kornizës së vlerësimit të performancës të PVSZ
- kalimi në nomenklaturën e aktiviteteve ekonomike NACE Rev. 2
- kuadri i burimit të të dhënave ende i pamjaftueshëm dhe mungesa e resurseve humane evidente.
- publikimi i rezultateve preliminare të Regjistrimit të Bujqësisë.
- harmonizimi i statistikave në mes të ASK-së dhe ministrive që janë prodhuese të statistikave
- fillimi i projektit IPA 2012 (MB) - Programi i bashkëpunimit statistikor me shumëpërfitues IPA 2012 dhe përgatitja adekuate për IPA 2

#### 6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE & QASJA

- Vendosja e DevInfo databazës në ueb-faqen e ASK-së me të dhënat e regjistrimit të popullsisë 2011.
- Ofrimi i të dhënave statistikore në ueb-faqen e ASK-së në formatin Excel për të gjitha departamentet statistikore.

Më poshtë është kalendari i publikimeve 2014.

<b>Kalendari i Publikimeve 2014</b>		
<b>Janar</b>		
<b>06 janar 2014</b>	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Nëntor 2013)
<b>14 janar 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Dhjetor 2013)
<b>31 janar 2014</b>	Buletini Tremujor	(Tetor - Dhjetor 2013)
<b>shkurt</b>		
<b>04 shkurt 2014</b>	Statistikat e Transportit	TM4/2013
<b>05 shkurt 2014</b>	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM4/2013
<b>06 shkurt 2014</b>	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Dhjetor 2013)
<b>12 shkurt 2014</b>	Katalogu i Publikimeve të ASK-së	2013
<b>14 shkurt 2014</b>	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM4/ 2013
<b>18 shkurt 2014</b>	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM4/2013
<b>19 shkurt 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Janar 2014)
<b>20 shkurt 2014</b>	Statistikat e Mirëqenies Sociale	2013
<b>21 shkurt 2014</b>	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në bujqësi	2005-2013
<b>25 shkurt 2014</b>	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në bujqësi	2005-2013
<b>mars</b>		
<b>10 mars 2014</b>	Gratë dhe Burrat në Kosovë	
<b>12 mars 2014</b>	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Janar 2014)
<b>13 mars 2014</b>	Statistikat e Hotelerisë	TM4/2013
<b>14 mars 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Shkurt 2014)
<b>19 mars 2014</b>	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM4/2013
<b>20 mars 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM4/2013
<b>24 mars 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM4/2013
<b>26 mars 2014</b>	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM4/2013
<b>27 mars 2014</b>	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM4/2013
<b>28 mars 2014</b>	Statistikat Afatshkurtra të Ndërtimit	TM4/2013
<b>prill</b>		
<b>1 prill 2014</b>	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shkurt 2014)
<b>14 prill 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Mars 2014)
<b>29 prill 2014</b>	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Mars 2014)
<b>30 prill 2014</b>	Buletini Tremujor	(Janar-Mars 2014)
<b>maj</b>		

## Harta Rrugore e ASK-së për vitin 2014

<b>06 maj 2014</b>	Statistikat e Transportit	TM1/2014
<b>07 maj 2014</b>	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM1/2014
<b>08 maj 2014</b>	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM1/2014
<b>14 maj 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Prill 2014)
<b>15 maj 2014</b>	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM1/2014
<b>16 maj 2014</b>	Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore	2013
<b>19 maj 2014</b>	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM1 /2014
<b>20 maj 2014</b>	Anketa e Fuqisë Punëtore	2013
<b>29 maj 2014</b>	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Prill 2014)
<b>30 maj 2014</b>	Kosova në Shifra	2013
<b>qershor</b>		
<b>11 qershor 2014</b>	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare	2013
<b>12 qershor 2014</b>	Statistikat e Arsimit për Arsimin Fillor (6-11 vjeç)	2013-2014
<b>13 qershor 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Maj 2014)
<b>16 qershor 2014</b>	Statistikat e Hotelarisë	TM1/2014
<b>17 qershor 2014</b>	Llogaritë Qeveritare	2013
<b>18 qershor 2014</b>	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM1/2014
<b>19 qershor 2014</b>	Lindjet në Kosovë	2013
<b>20 qershor 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM1/2014
<b>23 qershor 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM1/2014
<b>24 qershor 2014</b>	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	2013
<b>25 qershor 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	2013
<b>26 qershor 2014</b>	Indeksi i Kosotos së Ndërtimit	TM1/2014
<b>27 qershor 2014</b>	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM1/2014
<b>30 qershor 2014</b>	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Maj 2014)
<b>30 qershor 2014</b>	Statistikat Afatshkurtra të Ndërtimit	TM1/2014
<b>korrik</b>		
<b>08 korrik 2014</b>	Statistikat e Arsimit për parashkollor (3-6 vjeç)	2013-2014
<b>10 korrik 2014</b>	Vdekjet në Kosovë	2013
<b>14 korrik 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Qershor 2014)
<b>18 korrik 2014</b>	Kurorëzimet dhe Shkurorëzimet në Kosovë	2013
<b>30 korrik 2014</b>	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Qershor 2014)
<b>31 korrik 2014</b>	Buletini Tremujor	(Prill - Qershor 2014)
<b>gusht</b>		
<b>04 gusht 2014</b>	Statistikat e Transportit	TM2/2014
<b>05 gusht 2014</b>	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM2/2014
<b>13 gusht 2014</b>	Stat. për arsimin e ulët dhe të mesëm të lartë (15-19	2013-2014

Harta Rrugore e ASK-së për vitin 2014

vjeç)		
14 gusht 2014	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Korrik 2014)
15 gusht 2014	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM2/2014
19 gusht 2014	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM2/2014
28 gusht 2014	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM2/2014
29 gusht 2014	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Korrik 2014)
<b>shtator</b>		
11 shtator 2014	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Gusht 2014)
12 shtator 2014	Bruto Produkti Vendor – Qasja e Shpenzimeve	2013
15 shtator 2014	Statistikat e Hotelerisë	TM2/2014
16 shtator 2014	Statistikat e Arsimit Universitar	2013-2014
17 shtator 2014	Statistikat e Varfërisë	
18 shtator 2014	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM2/2014
19 shtator 2014	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM2/2014
23 shtator 2014	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM2/2014
25 shtator 2014	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM2/2014
26 shtator 2014	Stat. e jurisprudencës për persona të madhor	2013
29 shtator 2014	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM2/2014
30 shtator 2014	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Gusht 2014)
30 shtator 2014	Statistikat Afatshkurtra të Ndërtimit	TM2/2014
<b>tetor</b>		
01 tetor 2014	Stat. e jurisprudencës për persona të mitur	2013
14 tetor 2014	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Shtator 2014)
17 tetor 2014	Statistikat e Kulturës	2013
29 tetor 2014	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM3/2014
30 tetor 2014	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shtator 2014)
31 tetor 2014	Buletini Tremujor	(Korrik - Shtator 2014)
<b>nëntor</b>		
03 nëntor 2014	Statistikat e Transportit	TM3/2014
04 nëntor 2014	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM3/2014
05 nëntor 2014	Statistikat e Shëndetësisë	2013
12 nëntor 2014	Statistikat e Sportit	2013
13 nëntor 2014	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM3/2014
14 nëntor 2014	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Tetor 2014)
19 nëntor 2014	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM3/2014
19 nëntor 2014	Statistikat e Arsimit	2013-2014
25 nëntor 2014	Bruto Produkti Vendor- Qasja e Prodhimit	2013
27 nëntor 2014	Kalendari i Botimeve të ASK-së	2015
27 nëntor 2014	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Tetor 2014)

<b>dhjetor</b>		
<b>05 dhjetor 2014</b>	BPV me Qasjen e Shpenzimeve dhe Prodhimit	TM1/2014
<b>10 dhjetor 2014</b>	Fletëpalosja e ASK-ës	2014
<b>11 dhjetor 2014</b>	Shkaqet e Vdekjeve në Kosovë	
<b>12 dhjetor 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Nëntor 2014)
<b>15 dhjetor 2014</b>	Statistikat e Hotelerisë	TM3/2014
<b>16 dhjetor 2014</b>	Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve	2013
<b>17 dhjetor 2014</b>	Anketa e Mbeturinave Industriale	2013
<b>18 dhjetor 2014</b>	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM3/2014
<b>19 dhjetor 2014</b>		2015
<b>22 dhjetor 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM3/2014
<b>23 dhjetor 2014</b>	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM3/2014
<b>24 dhjetor 2014</b>	Kalendari i ASK-ës	2015
<b>26 dhjetor 2014</b>	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM3/2014
<b>26 dhjetor 2014</b>	Anketa e Mbeturinave Komunale	2013
<b>29 dhjetor 2014</b>	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM3/2014
<b>30 dhjetor 2014</b>	Statistikat Afatshkurtra të Ndërtimit	TM3/2014
<b>30 dhjetor 2014</b>	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Nëntor 2014)

## 7. BUXHETI

Për periudhën e përmendur të Hartës Rrugore 2013, buxheti për ASK të jetë si në vijim:

Tabela 1: Buxheti për ASK 2014

<b>Buxheti</b>	<b>2013</b>
	MF *
Pagat	608 798
Mallërat dhe shërbimet	377 000
Shpenzimet kapitale	
Shpenzimet kosto	37 500
<b>TOTAL:</b>	<b>1,023 298</b>
Numri i punëtorëve	139

Shenim: Me Ligjin e Buxhetit për vitin 2014, u muar vendim që buxheti i ASK-së të rritet për 75,000€

# ORGANOGRAMI I ASK-së

